# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-441358**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ekzaltimi qesharak, për vizitën “historike” të Berishës në SHBA |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/07/ekzaltimi-qesharak-per-viziten-historike-te-berishes-ne-shba/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 19:46:41 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 7 shtator 2026, 15:24:38 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `385ff36a534bfe9d55f607a143c3886ff7b853408554feeb0c11c47e6482d9e7` |
| TEKSTI | `6f95b8b59024eb280eb55b7b31b7d92fd9767eeaf2c752797f5e16c11867f890` |
| PAMJA | `1a5bdbde2cb43b2dfd1f4874882cddbb2c9d94af0a16244ae34a141e60719f97` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1fc88c2a195eaa3081ddafbab3ed2a0d7a84084d6ae6b9b835a2bfec9bc0be50` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1fc88c2a195eaa3081ddafbab3ed2a0d7a84084d6ae6b9b835a2bfec9bc0be50`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Ekzaltimi qesharak, për vizitën "historike" të Berishës në SHBA

Analizë

Publikuar: 07/09/2026



**Nga Bledi Lumani**

Sali Berisha prej dy ditësh ndodhet në SHBA.

Ai pritet të marrë pjesë në një konventë të republikanëve, ndërsa është takuar edhe me emigrantët shqiptarë që jetojnë aty.

Kuptohet në takim ka pasur edhe entuziasëm, pasi Berisha vazhdon të jetë një figurë e dashur për demokratët e hershëm, sidomos për ata që janë larguar që vitet e para nga Shqipëria, pasi e personifikojnë me njeriun që iu solli demokracinë.

Njeriu më entuziast, ka qenë vetë Sali Berisha, pasi 5 vjet pasi u shpall non grata familjarisht, për korrupsion madhor, pati mundësinë të udhëtojë drejt SHBA-së.

Non grata nuk ka rënë, por për të ka rëndësi që ndodhet në SHBA, gjë që po e shet si revansh ndaj kundërshtarëve të tij këtu në Tiranë.

Sepse në të vërtetë, kjo vizitë, bëhet pikërisht për këtë arsye.

Jo se do na rregullojë marrëdhëniet me SHBA, siç thotë Berisha, pasi ato në rregull kanë qenë e ashtu do të vijojnë të jenë, për sa kohë politika shqiptare do të jetë vasale e Amerikës.

Por të pataks ky entuziasmi qesharak i njerëzve që shoqërojnë Berishën, apo ata që kanë mbetur në Tiranë, që 24 orë në ditë dalin në TV apo bëjnë deklarata në rrjetet sociale, duke e quajtur vizitën e kreut të PD në Amerikë, si "historike" për Shqipërinë, në "këtë moment kritik për vendin".

Asgjë historike nuk ka kjo vizitë, as për Shqipërinë, as për vetë

## Më të lexuarat


Rama "djeg" Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e fundit, Spahi...


Benet Beci i dha tender Besnik Leskajt pasi Leskaj i mori në punë të birin. Postet në administrat...


I tmerrshmi i Beratit / Si ra Lulzim Caka në prangat e policisë greke për trafik kokaine, sa...


Pokalli padit Ramën në Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë biznesmenit izrae...


Emri i ri, borxhi i vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda saj

Berishën.

Për Shqipërinë jo e jo, se nuk ka ndodhur asgjë në marrëdhëniet Tiranë-Uashington.

Se jo për gjë, por Rama është i pari që iu ka dhënë “karta bianka” amerikanëve, që kanë dorë të lirë në Shqipëri.

Mjafton të kujtojmë këtu reformën në drejtësi, që u bë pikërisht me ngulmim të SHBA-së.

Por dhe për Berishën, asgjë historike nuk ka kjo vizitë.

Non grata për të mbetet, ashtu si dhe për familjen e tij.

Vizita e Doktorit, është thjesht një pelegrinazh, për t’iu treguar shqiptarëve se ai mund ta shkelë SHBA-në.

Por vetëm kaq.

Ndaj mirë është t’i shmangin këto deklarata qesharake, se historinë Doktori e ka mbyllur me kohë.

Dhe jo me nder, pavarësisht përpjekjeve të kushtueshme që bën prej vitesh, për t’iu mbushur mëndjen shqiptarëve, se SHBA ka gabuar me të.

TAG: Ekzaltimi qesharak vizita shba

## Të ngjashme



Kur pushteti politik abdikon ndaj atij gjyqësor



John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?



Demokracia jonë pa hardware dhe software?!

## Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

## Kategoritë

KREU INVESTIGIM
KRIM & KORRUPSION DOSJE ROZË
KRYESORE POLITIKË EKONOMI
ANALIZË RAJON KULTURË SPORT


klientelistë, krimit dhe biznesit jo të
ndershëm, të cilët në bashkëpunim
përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Email: [email protected]
Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena
Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.